

L I G J
Nr.8025, datë 9.11.1995

PËR MBROJTJEN NGA RREZATIMET JONIZUESE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj përcakton kushtet e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese për të gjitha veprimtaritë që kryhen me lëndë radioaktive dhe pajisje rrezatuese, për të mbrojtur punonjësit e ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimeve, popullatën dhe mjedisin në tërësi nga rreziqet e mundshme të rrezatimeve.

Neni 2

Në kuptim të këtij ligji:

- a) “Rrezatim jonizues” është rrezatimi elektromagnetik ose grimcor, i cili shkakton drejtpërdrejt ose tërthorazi jonizimin e lëndës me të cilën bashkëvepron.
- b) “Lëndë radioaktive” është çdo lëndë që në mënyrë të vetvetishme lëshon rrezatime jonizuese.
- c) “Pajisje rrezatuese” është çdo pajisje që përdoret për përfitimin e rrezatimeve jonizuese.
- ç) “Punë me rrezatime” është çdo veprimtari që kryhet duke përdorur lëndë dhe/ose pajisje rrezatuese.
- d) “Instalim rrezatues” është çdo njësi ku përdoren dhe/ose ruhen lëndë radioaktive dhe/ose pajisje rrezatuese.
- dh) “Mbetje radioaktive” është çdo lëndë radioaktive ose send i ndotur me lëndë radioaktive, që nuk mund të shërbejnë më gjatë për qëllime të dobishme.
- e) “Siguria bërthamore” është tërësia e kushteve që sigurojnë një punë normale me rrezatimet, parandalimin e aksidenteve ose zbutjen e pasojave të tyre, mbrojtjen e punonjësve, popullatës dhe mjedisit nga rrezatimet.
- ë) “Autoriteti kompetent” është komisioni i mbrojtjes nga rrezatimet, si organ i përcaktuar në këtë ligj për ushtrimin e detyrave dhe të drejtave në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese.
- f) “Zyra e mbrojtjes nga rrezatimet” është njësia ekzekutive e komisionit të mbrojtjes nga rrezatimet.
- g) “Licenca” është dokumenti që autorizon mbajtësin e saj të kryejë veprimtari me lëndë radioaktive dhe/ose pajisje rrezatuese.

Neni 3

Subjekti i dispozitave të këtij ligji është çdo person fizik e juridik, i cili:

- a) Zotëron, transferon, merr, përdor, fabrikon ose instalon pajisje rrezatuese.
- b) Kryen kërkime radiologjike, punime minerare, bluarje, ekstraktim, pasurim, shitje, transferim, import-eksport, dhënie me qira dhe ruajtje të lëndëve radioaktive.
- c) Trajton mbetje radioaktive, ushqime dhe produkte të tjera të ndotura me lëndë radioaktive.

Neni 4

Të gjithë personat fizikë e juridikë, vendas e të huaj, që kryejnë veprimtaritë e parashikuara në nenin 3 të këtij ligji, duhet të pajisen me licencë nga autoriteti kompetent. Procedura e pajisjes me licencë përcaktohet në rregulloren përkatëse.

Neni 5

Personat fizikë e juridikë të pajisur me licencë detyrohen të zbatojnë dispozitat e parashikuara në këtë ligj, si dhe në aktet e tjera të miratura në zbatim të tij.

KREU II ORGANIZIMI I STRUKTURAVE TË MBROJTJES NGA RREZATIMET

Neni 6

Pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit krijohet komisioni i mbrojtjes nga rrezatimet, i cili është autoriteti kompetent kombëtar që mbikëqyr dhe siguron zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet. Komisioni kryesohet nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe të paktën 50 për qind e anëtarëve të tij janë specialistë të mbrojtjes nga rrezatimet. Anëtarët e komisionit emërohen nga kryetari për një afat 4-vjeçar. Mënyra e shpërblimit të anëtarëve caktohet nga ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së Mjedisit.

Në varësi të komisionit të mbrojtjes nga rrezatimet ngrihet zyra e mbrojtjes nga rrezatimet, si organ ekzekutiv i saj. Kryetari i kësaj zyre është edhe sekretar i komisionit.

Neni 7

Komisioni i mbrojtjes nga rrezatimet ka këto detyra e të drejta:

- a) Nxjerr rregulloret, udhëzimet dhe aktet e praktikave të mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese dhe sigurinë bërthamore, të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë personat fizikë e juridikë.
- b) Kontrollon zbatimin e akteve ligjore e nënligjore mbi mbrojtjen nga rrezatimi.
- c) Pajis me licencë subjektet që kryejnë veprimtaritë e parashikuara në nenin 3 të këtij ligji.
- ç) Drejton nga ana teknike të gjitha autoritetet kombëtare dhe lokale për zbatimin e menjëhershëm të masave të nevojshme për zbutjen e efekteve të aksidenteve bërthamore.
- d) Bën rekomandime dhe propozime për përmirësimin e legjislacionit në fuqi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet.
- dh) Miraton standardet e sigurisë për mbrojtjen nga rrezatimet.
- e) Bashkëpunon me organizmat kombëtarë e ndërkombëtarë për problemet e mbrojtjes nga rrezatimet.
- ë) Angazhon institucionet kërkimore-shkencore në të gjithë vendin për zgjidhjen e problemeve kombëtare në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet.
- f) Përcakton strukturën organizative të zyrës së mbrojtjes nga rrezatimet, si dhe emëron dhe shkarkon drejtuesin e saj.
- g) Bashkëpunon me Inspektoratin Shtetëror të Punës.

Neni 8

Zyra e mbrojtjes nga rrezatimet ka këto detyra e të drejta:

- a) Paraqet për miratim në komision aktet rregulluese të veprimtarisë së mbrojtjes nga rrezatimet.
- b) Kontrollon në praktikë zbatimin e akteve ligjore e nënligjore në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet.
- c) Kryen inspektimin e instalimeve rrezatuese.

ç) Mbledh informacion dhe kryen matjet e analizat e nevojshme për kontrollin e mbrojtjes nga rrezatimet.

d) Përgatit dosjet për dhënien, pezullimin dhe heqjen e licencave dhe ia paraqet komisionit për miratim.

dh) Përgatit materialet e mbledhjeve të komisionit si dhe raportet e kërkuara prej tij.

KREU III DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 9

Komisioni i mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese miraton rregulloret mbi:

a) Procedurat e licencimit për veprimtaritë e parashikuara në nenin 3 të këtij ligji.

b) Mbrojtjen e popullatës dhe të mjedisit nga rrezatimet jonizuese.

c) Mbrojtjen e personave të ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimeve.

ç) Standardet dhe aktet praktike të veprimtarive me burime rrezatimi.

d) Masat e sigurimit për lëndët, pajisjet dhe instalimet rrezatuese.

dh) Veprimtarinë e zyrës së mbrojtjes nga rrezatimet.

Neni 10

Shkelja e dispozitave të parashikuara në nenet 4 dhe 5 të këtij ligji, kur nuk përbën vepër penale, dënohet si kundërvajtje administrative, me gjobë nga 10 mijë deri në 100 mijë lekë.

Gjobat jepen nga organet e kontrollit të caktuara nga komisioni i mbrojtjes nga rrezatimet.

Ankimi kundër vendimeve të organit të kontrollit dhe ekzekutimi i vendimeve bëhet sipas ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”.

Neni 11

Të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1293, datë 21.11.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha